



ODA EKONOMIKE E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE



# COVID-19 DHE NDIKIMI NË EKONOMI

## Mundësitë për rimëkëmbje dhe transformim ekonomik

---

Dhjetor 2020





# **COVID-19 DHE NDIKIMI NË EKONOMI**

Mundësitë për rimëkëmbje  
dhe transformim ekonomik.

---

Dhjetor 2020

**Autor:** Berat Rukiqi

Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

**Design:** Envinion

COPYRIGHT © 2020. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Odës Ekonomike të Kosovës.

# Përmbajtja

---

<b>Hyrje: Me çfarë lloj krize po ballafaqohemi?</b>	<b>6</b>
<b>Çfarë lloj politika i duhen ekonomisë?</b>	<b>8</b>
<b>Sa është e thellë kriza në Kosovë?</b>	<b>10</b>
<b>Si do të jetë e ardhmja?</b>	<b>11</b>
<b>Cilat kanë qenë politikat e deritashme të institucioneve të Republikës në menaxhimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia</b>	<b>13</b>
<b>Konkluzione dhe Rekomandime: Si mund të rimëkëmbet dhe transformohet ekonomia në Kosovë?</b>	<b>14</b>

## Hyrje: Me çfarë lloj krize po ballafaqohemi?

Fjalja “Është cunami ekonomik”, po përdoret gjërësisht për të përshkruar gjendjen e ekonomisë dhe tregjeve financiare ndërkombëtare, nga të gjithë analistët dhe ekspertët e ekonomisë botërore. Coronavirusi po i shtynë ekonominë drejt recesionit ekonomik, në një kohë kur të gjithë parametrat dhe trendet ishin me prirje pozitive. Sa më shumë që po përkeqësohet gjendja me pandeminë, secili e ka vështirë të vendosë, cilat biseda janë më të frikshme: bisedat që i kemi me epidemiologët apo bisedat që i kemi me ekonomistët dhe drejtuesit e kompanive. Distançimi social po shëndrrohet në distancim ekonomik. Njerëzit po kufizohen të shkojnë në dyqane, teatro, kinema, muze, bare, restorane dhe në vende të punës. Për të parandaluar shpërndarjen e pandemisë COVID-19, detyrimisht po shkohet drejt recesionit ekonomik, e më shumë gjasa, nëse e tëra zgjatë, edhe drejt depresionit ekonomik, në shkallën që nuk e kemi parë në ekonominë moderne.

Nuk ka asnjë situatë analoge në kohërat moderne. Ka një pajtueshmëri në mesin e ekspertëve që “dhimbja ekonomike” do të kalon në disa valë: Vala e parë është “ndalesa e paplanifikuar”, pra krejt papritur ndalen pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në gjithë vendin. Disa javë më herët, njerëzit kane shkuar në punë, kanë ngrënë në restorane, kanë paguar për shërbimet e veta, kanë prenotuar udhëtime dhe pushime, kanë planifikuar blerje të veturave, kanë qenë duke vlerësuar blerjen e një shtëpie të re, kanë mbajtur trajnime dhe konferenca. Tani, gati gjithëçka është stopuar. Njerëzit kanë gjetur strehën dhe sigurinë në shtëpitë e tyre dhe janë pasiv. Në valën e dytë, kur gjithëçka është e stopuar, njerëzit gradualisht mund t'i humbin vendet e punës. Në valën e tretë, të gjithë këta që mund të mbesin pa punë apo ata që rrezikojnë të humbin vendet e punës do të jenë në një panik, jo nga pandemia, por nga ankthi për të ardhmen. Asnjë nuk do të blejë veturën e re, shtëpinë e re, ose të planifikoj pushime këtë verë. Pavarësisht që një pjesë e madhe e kufizimeve të vendosura, për

të penguar përhapjen e pandemisë COVID-19, do të largohen gradualisht, hezitimi për konsum do të ngadalësojë rritjen ekonomike për një kohë shumë më të gjatë, pas përfundimit të pandemisë COVID-19. Në valën e katërt, bizneset që kanë planifikuar investime, do të heqin dorë nga çdo investim i ri, qoftë në linja të reja të prodhimit, zhvillim të produkteve të reja, apo investime në hapësira të reja të punës dhe në këtë mënyrë edhe një motor i rëndësishëm i rritjes ekonomike do të jetë i paralizuar.

Ekonomistët kryesorë po propozojnë “artilieri të rëndë” për të luftuar katastrofën ekonomike që mund të shkaktohet nga pandemia COVID-19. Qeveritë duhet të zvogëlojnë mundësitë e bankrotimit të individëve dhe ndërmarrjeve, të sigurojnë që njerëzit do të vazhdojnë të shpenzojnë, edhe nëse nuk janë duke punuar dhe të rrisin investimet publike dhe investimet në sistemet shëndetësore.

Kenneth Rogoff, Profesor i Ekonomisë dhe Politikave Publike në Universitetin e Harvardit, në një shkrim të botuar në platformën Project Syndicate nënvizon faktin që pasiguria për veprimet dhe sjelljet e njerëzve dhe e politikëbërësve në javët dhe muajt në vijim, është po aq e madhe, sa pasiguria shkencore në raport me Coronavirusin. Sipas Rogoff, “derisa të kemi një kuptimësi me të mirë, për atë se kur dhe si do të zgjedhet situata e shëndetit publik e lidhur me COVID-19, ekonomistët nuk do të mund të fillojnë të parashikojnë përfundimin e recesionit që tani është në rrugë e sipër. Por ajo që është mëse e sigurtë të presim, është që kjo rënie e ekonomisë, do të jetë shumë më e thellë dhe më e gjatë se ajo e vitit 2008.

Sipas Ricardo Hausmann, Profesor në John F. Kennedy School of Government në Harvard “Makroekonomistët fillimisht menduan që pandemia COVID-19 do të shkundë kërkesën agregate dhe kjo duhet të luftohet me politika që e rrisin konsumin. Por shumë shpejt e kuptuan, që për dallim nga



Në bazë të projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar ekonomia globale do të bjen në **- 3%**, që është rënie prej **6.3 pikë** të përqindjes, krahasuar me projeksionet e Janarit të vitit 2020. Kjo rënie pritet të shkaktoj recesionin më negativ që e kemi parë, që nga kriza e “Depresionit të Madh” dhe shumë më negative, se sa kriza globale financiare e vitit 2008.

kriza globale financiare e vitit 2008, e cila e kolapsoj kërkesën agregate, pandemia COVID-19, është para se gjithash shkundje e ofertës agregate”. Pra, edhe nëse njerëzit dëshirojnë të konsumojnë, të shkojnë në teatër, të dalin në restorane, të udhëtojnë, këtë do ta kenë të pamundshme, pasi që gjithçka duhet të jetë e mbyllur ose do të këtë masa që e bëjnë të pamundshme funksionimin e shumë bizneseve. Sipas Hausmann, kjo gjendje është e papërballueshme, sidomos për vendet në zhvillim. Këto vende varen nga eksporti i lëndës të parë, turizmi, remitencat dhe të gjitha pritet të pësojnë kolaps për këtë vit. Kjo do të ndikoj në fuqinë blerëse në këto vende dhe Qeveritë do të kenë problem me të hyrat buxhetore.

Në raportin për ekonominë botërore, të publikuar në javën e dytë të muajit Prill, Fondi Monetar Ndërkombëtar, e karakterizon krizën ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, si krizë që nuk e kemi parë asnjëherë më parë dhe për këtë arsye ka një pasiguri të madhe për ndikimin e saj në jetën e njerëzve. Shumica e vendeve në botë po ballafaqohen në të njëjtën kohë me krizë shendetësore, krizë financiare dhe rënie drastike të çmimit të lëndës së parë, përfshirë naftën. Në bazë të projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar ekonomia globale do të bjen në - 3%, që është rënie prej 6.3 pikë të përqindjes, krahasuar me projeksionet e Janarit të vitit 2020. Kjo rënie pritet të shkaktoj recesionin më negativ që e kemi parë, që nga kriza e “Depresionit të Madh” dhe shumë më negative, se sa kriza globale financiare e vitit 2008.

Në të njëjtën kohë, Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) ka konstatuar që tregtia globale është në rrugën e kolapsit, të ngjashëm me atë të vitit 1930, gjatë Depresionit të Madh. Sipas OBT-së, rimëkëmbja do të jetë më e shpejtë, nëse vendet i mbajnë tregjet e hapura, nuk vendosin barriera dhe veprojnë së bashku. Vlerësimet e OBT-së janë që tregtia botërore do të pësojë një tkurrje prej 13% deri 32%, varësisht nga kohëzgjatja e shpërthimit të pandemisë COVID-19 dhe kohëzgjatja e masave kufizuese që janë vendosur për parandalimin e përhapjes të pandemisë.

## Çfarë lloj politika i duhen ekonomisë?

Ekonomia moderne është një strukturë komplekse e shumë palëve të ndërlidhura: qeveritë, punëtorët, ndërmarrjet, furnizuesit, konsumatorët, bankat dhe institucionet tjera financiare, etj. Secili është punëtor i dikujt, konsumator i dikujt, huadhënës i dikujt. Një ndalesë e papritur, krijon reaksion zingjiror, e cili mund të arsyetohet në rrafshin individual, por do të pasohet me dëme kolektive katastrofike. Konsumatori i vetëizoluar, i ballafaquar me pasiguri për të ardhmen, e zvogëlon vazhdimisht blerjen. Kjo e bën të pamundshme për ndërmarrjet të krijojnë të ardhura dhe të njejtat detyrohen të ulin shpenzimet, duke zvogëluar edhe numrin e vendeve të punës, për të shmangur katastrofën totale. Bankat, për të ruajtur stabilitetin dhe për të mos rritur ekspozimin, në raport me kreditë joperformuese, e ulin kredidhënien, duke e errësuar edhe më shumë perspektivën e sektorit jo-financiarë. Paniku dhe ulja e konfidencës janë edhe një shtresë tjetër në problemin me shumë të panjohura. Edhe pa masa izoluese dhe të distancimit social, recesioni do të ishte i prishëm. Pasi që paniku, paqartësitë, mungesa e konfidencës, do të ndikonin në ulje të konsumit dhe të investimeve.

Njejtë, si të sistemi shendetësor, sistemi ekonomik duhe të këtë “kujdesin intenziv, shtretërit dhe ventilatorët”, për përballim me krizën. Në një sistem ekonomik këtë rol e luajnë: bankat qendrore me politika monetare dhe qeveritë me masa fiskale. Një gjë është e qartë: me asnjë politikë ekonomike, nuk mund të shmanget recesioni. Recesioni është duke ndodhë, por të shpresojmë të jetë afatshkurtë. Në këtë rast, objektivi kryesor i politikave duhet të jetë shënjestrimi i të gjitha kanaleve që mund të ndikojnë në thellimin e problemit, duke ndërmarrë veprime të shpejta dhe në kohën e duhur. Aspekti kohor i zbatimit të masave është më rëndësi. Masat duhet të zbatohen në mënyrë efikase gjatë tërë kohëzgjatjes të mbylljes, kufizimeve dhe masave të distancimit social. Masat duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Ka pak rrezik nëse veprimet shumë për të stabilizuar ekonominë; rreziku është nëse veprimet pak.

Në vitin 2008 ka qenë një pyetje, “Sa shpejt mund të rimëkëmbet ekonomia?” Në vitin 2020, në kohën e pandemisë COVID-19, po ballafaqohemi me dy pyetje, të cilat janë në konflikt njëra me tjetrën. E para, si t’i ndalim vdekjet nga Coronavirus? E dyta, si të sigurohemi që ekonomia mund të rimëkëmbet, pasi që të kthehemi në normalitet? Asnjë libër, asnjë teori, asnjë praktikë, nuk na ka mësuar si t’i japim përgjigje të dyjave pyetjeve në të njejtën kohë. Por ajo që dihet deri tani, bazuar edhe në praktikën e Kinës, vetëm zgjidhja e problemit të shëndetit publik, pra vendosja në kontroll e virusit, mund të ndihmojë dhe të shpejtojë rimëkëmbjen ekonomike.

Duhet politika që e bëjnë të mundshme që paratë të shpërndahen tani dhe me efikasitet të lartë në xhepat e familjeve. Poashtu duhet të pranohet faktin që kjo nuk mjafton. Sipas Paul Krugman, kolumnist i rregullt në New York Times dhe fitues i çmimit Nobel për ekonomi, “në recesione tipike, prioritetet i politikave monetare dhe fiskale është kthimi sa më shpejtë i njerëzve në punë. Por kjo është fatkeqësi natyrore dhe roli i Qeverisë është të ndihmojë familjet të mos futen në katastrofë ekonomike”. Ivan Krastev nga European Council on Foreign Relations në këndvështrimin e tij për ndikimet e mundshme të pandemisë COVID-19, thotë që kjo pandemi do të sforcojë idenë e kthimit të “Qeverisë të madhe”, përmes intervenimeve stimuluese në ekonomi.





Kalkulimet bazike janë që një muaj me kapacitet të prodhimit në **50%** dhe dy muaj tjerë me kapacitet prodhues jo më shumë se **25%**, do të ndikojnë në një rënie deri në **10%**, të outputit vjetor në një ekonomi.

**Sipas Mike Konczal, hulumtues në Roosvelt Institute, janë pesë elemente për ngadalësim të recesionit dhe kufizim të ndikimeve të mundshme negative:**

- a) Ndihma direkte për qytetarët duke ju ofruar para të gatshme;
- b) Përkrahje për punëtorët për t'i siguruar që ka një kujdes për ta;
- c) Përkrahje të bizneseve dhe komunave me masa të politikës fiskale dhe monetare;
- d) Parandalimi i kolapsit të bizneseve, përmes ofrimit të mjeteve për likuiditet, përfshirë edhe mundësinë që qeveria të jetë konsumator fundor, për një pjesë të stokut të produkteve të tyre, me kushtin që kompanitë nuk i largojnë punëtorët nga puna
- e) Për industrinë/sectorët që mund të bankrotojnë, të krijohen mekanizma stimulues që e bëjnë të mundshme rimëkëmbjen e tyre, përmes një kornize të qartë të qeverisjes korporative dhe financiare, përfshirë kufizimin e dividendëve dhe bonuseve.

Kalkulimet bazike janë që një muaj me kapacitet të prodhimit në 50% dhe dy muaj tjerë me kapacitet prodhues jo më shumë se 25%, do të ndikojnë në një rënie deri në 10%, të outputit vjetor në një ekonomi. Mbi këtë bazë, do të duhej të llogariten masat emergjente, masat stimuluese dhe masat e rimëkëmbjes në ekonomi. Pra aq sa pritet të këtë rënie të outputit në ekonomi, aq do të duhej të ishte edhe stimulimi në ekonomi, me masa të politikës monetare dhe masa të politikës fiskale.

## Sa është e thellë kriza në Kosovë?

Në raportin për Kosovën, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që është publikuar në fillim të muajit Prill, konstatohet që pandemia COVID-19, e ka goditur rëndë ekonominë e Kosovës. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, ekonomia e Kosovës do të pësoj një tkurrje prej 5%. Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka parashikuar që do të ketë një rritje ekonomike prej 3.5%. Sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, shpërthimi i pandemisë do të ndikoj me rënie prej 20% në sektorin e turizmit, kryesisht i lidhur me vizitat e rregullta nga diaspora, të cilat për shkak të kufizimeve në udhëtime, e kanë bërë gati të pamundshme realizimin e këtyre vizitave. Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon rënie prej 19% në eksporte, si pasojë e rënies së kërkesës në nivel global dhe rënie prej 10% në remitenca, për shkak të efekteve negative të pandemisë COVID-19, në vendet nga është origjina e remitencave. Poashtu pritet rënie në Investimet e Huaja Direkte dhe në të hyrat tjera financiare. Edhe Banka Botërore, në raportin e muajit Tetor 2020, për të gjitha vendet e rajonit, përfshirë Kosovën dhe të gjitha vendet e prekura nga COVID-19, parashih vështirësi ekonomike. Sipas Bankës Botërore, ekonomia e Kosovës, pritet të ketë tkurrje prej 8.8% si pasojë e krizës të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Në bazë të raportit të fundit të Bankës Botërore për Kosovën, të publikuar në muajin tetor të këtij viti, “përkundër lehtësimit në muajin qershor 2020 të masave frenuese, ekonomia vazhdon të jetë në rënie, meqë tronditja nga COVID-19 është duke ndikuar negativisht shërbimet e eksporteve të nxitura nga diaspora, investimet dhe konsumin privat. Ekonomia e Kosovës pritet të tkurret me 8.8 për qind në vitin 2020”.

Hulumtime tjera të besueshme, poashtu tregojnë ndikime shumë negative të pandemisë COVID-19, në ekonominë e Kosovës. Për të matur ndikimin e masave kufizuese, kundër përhapjes të pandemisë COVID-19, në sektorin privat, pesë organizata që

përfaqësojnë interesat e biznesit, kanë kryer një anketë të përbashkët. Sipas kësaj ankete, përkatësisht të dhënave të përpunuara dhe të analizuara nga Recura Financials, 95% e ndërmarrjeve të anketuara e vlerësojnë krizën e shkaktuar nga COVID-19, si negative. 60% e ndërmarrjeve të anketuara besojnë se pandemia COVID-19 rrezikon mbijetesën e tyre, ndërsa 30% e ndërmarrjeve të anketuara janë deklaruar se kanë zvogëluar numrin e të punësuarve.

Edhe në hulumtimin e fundit të Odës Ekonomike të Kosovës me të cilin matet çdo 4 muaj klima e të bërit biznes dhe konfidenca e bizneseve në sektorët me relevancë të ekonomisë, tremujori i II-të i vitit 2020, tregon një gjendje jo të mirë të bizneseve në vend. Rreth 80% e bizneseve kanë vlerësuar se kanë një gjendje jo të kënaqshme biznesore. Në krahasim me tremujorin paraprak gjendja në këtë tremujor është përkeqësuar akoma më shumë, përqindja e bizneseve që vlerësojnë situatën aktuale të pakënaqshme është më e madhe për 47 pikë të përqindjes.

**Indikatori i konfidencës poashtu ka shënuar rënie të madhe në krahasim me TM paraprak (rreth 37.3 pikë të përqindjes).** Konfidenca në rënie kryesisht u ndikua nga deklaratimet negative të sektorëve kyç ekonomik në vend. **Indikatori i konfidencës në këtë tremujor është -44.7, dhe njëherit dhe vlera më negative e shënuar ndonjëherë që nga vitit 2013 kur ka filluar të realizohet ky indikator.**

## Si do të jetë e ardhmja?

Në një intervistë për National Public Radio (SHBA), Historiani YUVAL NOAH HARARI, flet për botën e Transformuar pas Pandemisë: "Ka eksperimente gjithandej. Universitetet po i mbajnë mësimet online, që është menduar të bëhet tani e disa vite, por anjëherë nuk është vepruar. E tani ky është një eksperiment i madh. Tjetra, çka do të ndodh me miliona njerëz, që do të fillojnë të punojnë prej shtëpisë, në vend që të shkojnë në fabrikë? Pra do të kemi shumë eksperimente sociale, në shkallë masive, të cilat do ta ndryshojnë botën. Teknologjia do të na ndihmon të përshtatemi në ekstremin që e kemi tani. Mobiliteti fizik mund të reduktohet duke i lëvizur një pjesë të mirë të aktiviteteve tona në "Cyberspace". Shkollat, zyret, universitetet, hapësirat e punës, me gjasë do të ndryshojnë në mënyrë permanente dhe shumë më shpejt se sa është menduar dhe projektuar deri tani.

Ka një pajtueshmëri në mesin e analistëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, që pas përfundimit të pandemisë COVID-19, "asgjë nuk do të jetë e njejtë". Do të jetë një "normalitet i ri", me shumë ndryshime në mënyrën e jetesës dhe në mënyrën e të bërit biznes. Priten ndryshime në sjelljen e konsumatorëve, mësimin dhe punën online ju është dhënë një shtytje e madhe, distanca sociale do të bashkëjetojë për një kohë të gjatë me neve, ndërsa bizneset do të kujdesen që burimet e prodhimit dhe furnizimit t'i kenë sa më afër vendit të operimit. Zhvendosja e prodhimit sa më afër vendit të prodhimit dhe operimit, do t'i shtyj kompanitë prodhuese për investime me të mëdha në automatizim, inteligjencë artificiale, dixhitalizim të proceseve dhe organizim të punës në "ndërrime fizike", me punëtorë që duhen të jenë domosdoshmërisht fizikisht prezentë, gjatë procesit të prodhimit dhe me "ndërrime virtuale", me punëtorë dhe ekspertë që janë të lidhur me procesin e prodhimit, të cilët mund të udhëheqin procesin e prodhimit, apo të japin këshillat dhe mendimin e tyre për proceset, por këtë do ta bëjnë virtualisht dhe nga distanca.

Ndryshime priten edhe në rrjedhat e tregtisë dhe organizimit të zinxhireve prodhuese dhe të furnizimit. Ndikimi i pandemisë COVID-19, në rrjedhat e tregtisë është i dukshëm. Turrja ekonomike ka reduktuar kërkesën për importe dhe ka ndikuar në kolapsin e shumë zhvillimeve në tregti. Nga ana e politikave, ndërprerja e furnizimeve, si dhe mungesa e furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore, kanë vendosur fokusin në sigurinë e rrjeteve prodhuese dhe furnizuese. Çka do të ndodhë kur të kalon emergjenca në shëndetin publik? Votuesit, ndërmarrjet dhe qeveritë do t'i rivlerësojnë në shkallë të madhe pritjet dhe zonën e tolerancës për rrezikun në raport me pjesë të ndryshme të ekonomisë.

Prej vitit 1980 deri në vitin 2007, "globalizimi" ka përshpejtuar shkëmbimet tregtare dhe ka rritur standardet e jetesës. Përfitimet e shpejta në teknologjitë e komunikimit dhe informacionit, krahas inovacioneve, kanë ndikuar dukshëm në reduktimin e barrierave për lëvizjen e mallrave, shërbimeve, njerëzve, dijes, ideve dhe kulturave. Në të njejtën kohë, shumë qeveri, si rrjedhojë e dështimeve të politikave të ekonomisë së planifikuar dhe proteksionizmit, lëvizën shpejtë drejt hapjes së ekonomive dhe tregtisë së lirë, të bazuar në rregullat e GATT (Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregti dhe Tarifa) dhe më vonë brenda kornizave dhe rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë. Marrëveshjet rajonale të tregtisë, përfshirë: Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian, NAFTA, ASEAN, dhe dhjetëra marrëveshje bilaterale të tregtisë, kanë ndikuar në thjeshtësimin e tregtisë ndërmjet vendeve, duke rritur specializimin, brenda rrjeteve të prodhimit dhe furnizimit. Kjo qasje ka dhënë rezultatet e veta. Pjesëmarrja e tregtisë në outputin global nga 13% sa ishte në vitin 1989, u rrit në 28% në vitin 2007.

Kjo periudhë e ndritshme në tregtinë dhe ekonominë globale, filloj të ndryshojë në vitin 2008, pas krizës financiare në nivel global. Që nga ajo kohë kemi shumë mosmarrëveshje mes vendeve, probleme në iniciativat e reja për lehtësim dhe liberalizim të



Marrëveshjet rajonale të tregtisë, përfshirë: Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian, NAFTA, ASEAN, dhe dhjetëra marrëveshje bilaterale të tregtisë, kanë ndikuar në thjeshtësimin e tregtisë ndërmjet vendeve, duke rritur specializimin, brenda rrjeteve të prodhimit dhe furnizimit. Kjo qasje ka dhënë rezultatet e veta. Pjesëmarrja e tregtisë në outputin global nga **13%** sa ishte në vitin 1989, u rrit në **28%** në vitin 2007.

tregtisë, probleme në reformën brenda Bashkimit Evropian, dalja e Britanisë nga Bashkimi Evropian, ngecje në raportet tregtare transatlantike, si dhe në mes vendeve aziatike, vendeve të Paqësorit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vitin 2017, një dekadë pas “pikut në tregti”, pjesëmarrja e tregtisë në outputin global, ra në 22%. Nëse një kohë liberalizimi në tregti është parë si “marrëveshje e mirë”, tani rënia në nivel global, pasojat e krizës financiare dhe popullizmi në rrijte, po ndikon që një pjesë e madhe e vendeve ta shohin liberalizimin e tregtisë me skepticizëm.

Rrjetet e prodhimit po vazhdojnë përshtatjen, me apo pa një agjendë të politikave lokale apo atyre globale. Tregjet në zhvillim nuk janë më vetëm konsumatorë, por janë shëndrruar edhe në prodhues. Produktet finale kanë një komponentë të theksuar të inovacionit dhe dijes brenda vetes, ndërsa metodat e prodhimit po bëhen më të sotistifikuara. Zingjiret e vlerave në baza rajonale po përformojnë shumë më mirë, se sa zingjiret e vlerave që bazohen në sisteme të mëdha globale, si dhe tregtia në shërbime ka filluar të tejkaloj vlerën e tregtisë në mallra.

Çka do të ndodh me zingjirin global të prodhimit dhe furnizimit, pasi që të largohet rreziku nga pandemia COVID-19? Së pari duhet të pritet që zingjiri furnizues do të bëhet më i adaptueshëm, më fleksibil, dhe të zhvillohet në varësi nga rrethanat. Së dyti, kompanitë do t'i rivlerësojnë mënyrat e furnizimit, duke u larguar nga furnizimet një burimore, ndërsa qeveritë dhe inistucionet shendetësore do të rivlerësojnë stoqet dhe burimet e furnizimit për pajisje dhe furnizime mjekësore, duke e ndryshuar vlerësimin për atë se çka konsiderohet furnizim i sigurtë dhe adekuat.

# Cilat kanë qenë politikat e deritashme te institucioneve të Republikës në menaxhimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia

---

Për të adresuar pasojat negative të pandemisë, COVID-19 në ekonominë e Kosovës, Qeveria e Kosovës fillimisht ka miratuar një pako emergjente, në vlerë prej 179 milionë euro. Kosto e masave emergjente të Qeverisë është rreth 2.5% e GDP-së dhe këto masa fokusin e kanë në transfere për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, si dhe ndërmarrjet me të goditura nga sektorë të ndryshëm; avancime të skemave sociale duke ju shtuar pagesa shtesë për një muaj; buxhet shtesë për Minsitrinë e Shëndetësisë; shtyrje të deklarimeve dhe të pagesave të tatimeve, përfshirë tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimin në të ardhurat personale dhe tatimin në vlerën e shtuar. Në të njëjtën kohë Banka Qendrore e Kosovës ka sjell vendim për suspendimin e pagesave të kredive fillimisht deri me 30 Prill 2020, me mundësi të vazhdimit edhe për muaj tjerë. Në bazë të vlerësimeve të bizneseve në hulumtimin e realizuar nga pesë organizatat biznesore, bizneset i kanë vlerësuar të pamjaftueshme masat e ndërmarra nga institucionet e vendet. Hulumtimi i lartëcekur, i kryer nga pesë organizata biznesore, tregon që vetëm 6% e të anketuarve vlerësojnë se masat kanë lehtësuar në masë të madhe vështirësitë e të bërit biznes, krahasuar me një përqindje të ngjashme të atyre që vlerësojnë se masat nuk lehtësojnë aspak vështirësitë e tyre.

Gjatë muajit Korrik (2020) Qeveria ka miratuar Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike, duke ndarë 365 milionë euro për të përkrahur bizneset në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës, si dhe për të stimuluar kërkesën agregate. Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, përfshinë masa për lehtësimin e qasjes në financa për bizneset, subvencione shtesë për bujqit, lehtësira të ndryshme tatimore, subvencionim të pagave për punëtorët, si dhe mundësinë që qytetarët të tërheqin 10% të kontributeve të tyre të akumuluar në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

## Konkluzione dhe Rekomandime: Si mund të rimëkëmbet dhe transformohet ekonomia në Kosovë?

Kërcënimi i përbashkët që e kemi duhet të na bëjë të gjithëve bashkë me disa nga fuqitë kryesore që i ka njerëzimi: solidaritetin, kurajon, kreativitetin dhe lirinë e të menduarit. Vënia në funksion e këtyre fuqive, na duhet edhe në rrugën tonë drejt rimëkëmbjes dhe transformimit ekonomik. Krizat janë edhe mundësi e mirë për ndryshim, përshtatje dhe vënie në funksion të energjive të reja për një transformim më gjithëpërfshirës. Në një artikull të publikuar para disa javësh, bashkë me Drejtorin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zekën dhe me ndërmarrësin Visar Ramajli, kemi argumentuar që “Kosova kishte huqur dy mundësi për të krijuar modele të duhura të zhvillimit ekonomik – në vitin 1999 kur ishte çliruar nga okupimi dhe në vitin 2008 pas shpalljes së pavarësisë. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme pozitive përgjatë viteve, burimet e kësaj rritje ishin tërësisht të paqëndrueshme. Si asnjëherë përgjatë dy dekadave të fundit, Kosova ka shansin e ri unik për të bërë ndryshimin. Pakoja e rimëkëmbjes duhet të bazohet në disa shtylla të rëndësishme: (1) Pakti Kombëtar për Transformim Ekonomik, do të përfshijë të gjithë hisedarët vendimmarrës në vend, sektorin privat dhe sektorin financiar. Synimi i paktit duhet të jetë përcaktimi i prioriteteve afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra për zhvillimin ekonomik të vendit, përmes politikave, instrumenteve dhe masave që e vendosin sektorin privat në pozicionin e tij të merituar – në gjenerator të rritjes ekonomike. Të gjitha prioritetet, politikat, instrumentet dhe masat duhet të plotësojnë tri kritere bazë: Të jenë në harmoni të plotë me rregullat e ekonomisë së tregut; të bazohen në të dhëna dhe analiza ‘cost-benefit’, si dhe të jenë të buxhetuara, duke përfshirë edhe identifikimin e burimeve të financimit, ku rol të patjetërsueshëm luajnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare dhe komuniteti i donatorëve. (2) Thelbi i transformimit ekonomik duhet të jetë modeli

i ri zhvillimor, i bazuar në një strategji që mundëson një largim gradual të varësisë nga burimet jostabile të rritjes ekonomike, përfshirë investimet publike dhe remitencat, e këto të fundit duhet të zëvendësohen me investime direkte nga diaspora. Modeli i ri zhvillimor duhet të fokusohet në sektorët që kanë aftësi konkurruese, me potencial të lartë për eksport dhe integrim në zinxhirët furnizuesë rajonale dhe globale. Për forcimin e këtyre sektorëve me aftësi konkurruese, duhet të nxiten investime të jashtme. Promovimi i mundësive për investime duhet të ketë në fokus ndërmarrjet ndërkombëtare të cilat synojnë stabilizimin e zinxhirit të furnizimit dhe ruajtjen e aftësisë konkurruese, pas një largimi të mundshëm të tyre nga vendet aziatike. (3) Modeli i ri zhvillimor nënkupton edhe ndryshim të mendësisë së të bërit biznes. Paradigmi i këtij modeli nuk mund të paramendohet pa aspektin digjital. Prandaj, sektorët me potencial konkurrues dhe shërbimet përcjellëse për këta sektorë, duhet të kalojnë në një proces holistik të transformimit digjital. Kufizimet e aktiviteteve ekonomike si rezultat i pandemisë COVID-19, e kanë vënë nevojën e transformimit digjital të bizneseve në një dimension të ri. Të gjitha industritë duhet të shfrytëzojnë mundësitë që ofrohen nga digjitalizimi, si për të rritur përparësitë konkurruese, ashtu edhe për t’u mbijetuar vështirësive si këto të shfaqura pas pandemisë. Megjithatë, për një sukses më të madh, digjitalizimi duhet të integrojë edhe qeverisjen dhe shërbimet publike, por edhe edukimin dhe kujdesin shëndetësor. (4) Për një model të ri zhvillimor duhen financa dhe kapital njerëzor. Buxheti i vendit dhe resurset ekzistuese financiare janë të pamjaftueshme për nisjen e një cikli të ri të zhvillimit të vendit. Prandaj na duhet të avancojmë instrumentet ekzistuese të sistemit financiar, për të rritur kapitalin në treg, përmes krijimit të fondeve investive, të cilat mund të akumulojnë mjete

nga qytetarët, bizneset, diaspora, institucionet financiare, etj. Përmes fondeve investive private do të finançohej rritja e ndërmarrjeve tona në tregjet ndërkombëtare, rritja e kapaciteteve prodhuese dhe projektet e rëndësishme strategjike. Ndërsa, sa i përket kapitalit njerëzor, nevojitet një transformim i plotë i sistemit të edukimit i cili duhet të reflektojë tiparet dhe sjelljet e gjeneratave të reja, por edhe nevojat reale të tregut të punës dhe prioritetet e Paktit Kombëtar të Transformimit Ekonomik. Investimet e huaja direkte do të kishin rol kyç, si në aspektin e kapitalit financiar, ashtu edhe në aspektin e transferimit të njohurive”.

Në plan afatshkurtë dhe afatmesëm Politikën e Rimëkëmbjes, përveç atyre që janë të miratuara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike, duhet të orientohen në sigurimin e konfidencës për bizneset dhe për konsumatorët dhe në qarkullimin e pandërprerë të parasë në treg.

### **Për të arritur këtë qëllim rekomandohen këto veprime institucionale:**

- 1) Investimet në sistemin shëndetësor për të adresuar shëndetin e qytetarëve dhe për ta mbajtur virusin nën kontroll
- 2) Fokus në dixhitalizim të administratës dhe të reduktimit të burokracisë. Gjithashtu kompanitë të finançohej për dixhitalizim të proceseve të tyre biznesore dhe rritje të aktiviteteve biznesore përmes tregtisë elektronike
- 3) Program të përkrahjes të integritit të kompanive kosovare në zingjirët global të furnizimit
- 4) Program të veçantë financiar për përkrahjen dhe promovimin e sektorit të turizmit dhe të gastronomisë, dy ndër sektorët me të goditur nga pandemia
- 5) Krijim të lehtësirave tatimore dhe ligjore për sektorin e ndërtimit, sektor që mund të përfshihet nga kriza, në muajt në vijim, si pasojë e problemeve në cash-flow-n e kompanive aktive

në këtë sektor, përfshirë uljen e taksave për ndërtim dhe krijimin e bazës ligjore për regjistrim të përkohshëm kadastral të objekteve në ndërtim

- 6) Stimulim të kërkesës agregate përmes stimulimit të blerjeve në periudha të caktuara (për shembull 0% TVSH për blerjet gjatë fundjavës)
- 7) Krijim të instrumenteve financiare, për financim të tranzicionit në energji, drejt zgjidhjeve me të qëndrueshme dhe me eficiency të furnizimit me energji, për bizneset dhe ekonomitë familjare

Rimëkëmbja dhe transformimi ekonomik do të varen nga një numër i madh i faktorëve, përfshirë mundësitë e ndonjë shpërthimi të ri të pandemisë, kohëzgjatja e pandemisë dhe ndikimi i saj në konfidencën e konsumatorëve dhe të bizneseve, por edhe nga aftësia e bizneseve për tu përshtatur me “normalitetin e ri”. Qeveria duhet të jetë proaktive në sigurimin e mbështetjes adekuate për qytetarët dhe bizneset, por edhe fleksibile në të njëjtën kohë për tu përshtatur me çdo rrethanë të re që mund të krijohet.



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

